

# **PROPOZIM PROGRAM PËR PUNË**

## **Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) për periudhën 2023-2026**

**Miladen Çadikovski**  
Kandidat për kryetar i SHGM-së

*Dhjetor, viti 2022, Shkup*

Të nderuara kolege dhe kolegë,

Në katër vitet e kaluara Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) ka punuar si organizatë e cila arriti të imponojë narrativ të ndryshëm në shoqërinë tonë. Çdoherë kur liria e gazetarëve dhe kameramanëve ishte sulmuar ne ishim këtu për anëtarët tonë dhe kolegë, ndërsa në të njëjtën kohë kemi punuar edhe për përmirësimin e kushteve të punës. Kemi krijuar, jemi shoqëruar, trajnuar, në drejtim të rritjes së solidaritetit mes gazetarëve dhe gazetarëve.

Solidariteti në fellën e gazetarëve në nivel të tërë shtetit, si asnjëherë më parë është në nivelin më të lartë, SHGM sot numëron pothuajse 1000 anëtarë, që është numri më i lartë i anëtarëve aktiv dhe të përkohshëm, që nga ekzistimi i kësaj organizate. Për këtë kanë kontribuar përpjekjet tona të përbashkëta, të gazetarëve anëtarë të SHGM-së, organeve të SHGM-së, Këshillit Drejtues, Këshillit Mbikëqyrës, Këshilli i Nderit dhe Qendrat rajonale në tërë shtetin.

Sjellja e vendimeve në bazë të principeve, përpjekjet për tu përgjigjur në çdo kërkesë të çdo anëtari, puna aktive e organeve dhe seksioneve të kameramanëve, gazetarëve të sportit, gazetarëve të rinj, fotoreporterëve, kritikuesve filmik, kanë kontribuar në ngritjen e standardeve të punës në SHGM. Ka shumë gjëra që nuk janë realizuar, për të cilat nevojitet më shumë kohë dhe më tepër përpjekje.

Mund të premtoj profesionalitet dhe respektim të principeve, të cilat edhe përsëri nuk kemi lëshuar pe, ndërsa këtë nuk do ta bëjmë as në katër vitet e ardhshme. Ky është programi im që doli nga të gjitha bisedat me Ju, kolegë dhe bashkëpunëtorë të mi.

## **FOND PËR PRODUKTE MEDIATIKE**

- Formimin e një Fondi për produkte mediatike dhe gazetareske për ngritjen e kualitetit të gazetarisë dhe njëkohësisht standardin e gazetarëve
- Fondi parashikon sigurimin e të hollave për produktet gazetareske nga të gjitha zhanret, për TV, Radio, Online, gazetat, në nivel rajonal dhe lokal
- Grupe qëllimore: Medime dhe grupe të gazetarëve dhe kameramanëve, do të mund të aplikojnë për forma të raportimit të avancuar, analiza, hulumtime, programe dokumentare, programe debatuuese, në të gjitha mediat
- Propozimi po punohet në bashkëpunim me Shoqatën e Medimeve Lokale dhe Rajonale “Medium Objektiv”.
- Fillimi i punës së Fondit / deri në fund të vitit 2023

## **SIGURIA E GAZETARËVE**

- Miratimin e Ligjit me të cilin sulmet mbi gazetarët do të llogariten si sulme ndaj personave zyrtarë  
Afati: Janar 2023
- Vazhdimin e mbajtjes së evidencës të sulmeve mbi gazetarët dhe insistimin për të zgjidhur çdo rast para MPB-së, PTHP-së dhe gjykatave
- Ndhimë juridike falas në formën e këshillimit juridik, përfaqësim para gjykatës dhe ndjekje të seancave gjyqësore në të cilat ka gazetarë si palë. Momentalisht ka mbi 50 padi aktive për shpifje ndaj gazetarëve, dyfish më shumë se vitin e kaluar.
- Reagime të shpejta publike, konferenca për media dhe komunikata për çdo sulm
- Vazhdim të bashkëpunimit me PTHP-në dhe me prokurorin e posaçëm i angazhuar për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve i emëruar më kërkesë të SHGM-së dhe SPGPM-së.
- Ndjekjen e seancave në të cilat gazetarët janë palë me qëllim qasjen e plotë në praktikën gjyqësore kur bëhet fjalë për gjykime në të cilat njëra palë është gazetarë dhe/ose punonjës mediatik.
- Vazhdimin e organizimit të ngjarjeve si trajnime dhe konferenca në mes punonjësve mediatik dhe përfaqësuesve të gjyqësorit.

- Vazhdimin e përpunimit të përbashkët të protokolleve për siguri të gazetarëve së bashku me MPB-në dhe organet gjyqësore.
- Shkrimi dhe publikimi i analizave lidhur me temën e sigurisë së gazetarëve dhe promovimin e këtyre çështjeve para opinionit të gjerë.

## **SHPIFJE NDAJ GAZETARËVE- PËR PESË HERË ULJE TË DËNIMEVE**

- SHGM ka iniciuar dhe ka ndërmarrë rol aktiv në kuadër të ASHAM për rishikim të Ligjit për përgjegjësi për shpifje dhe ofendim.
- Si rezultat i angazhimit dhe kontributit aktiv të SHGM-së, dënimet potenciale për gazetarët u ulën pesë herë më propozimin e ri.
- Miratimi i këtyre ndryshimeve nga ana e Kuvendit gjatë nëntorit të vitit 2022 është një hap i mirë dhe paraqet mbrojtje shtesë të punonjësve mediatik nga keqpërdorimi potencial i këtyre padive.

## **RADIO TELEVISIONI I MAQEDONISË (RTVM)**

- Insistimi për reforma të shpejta në servisin publik nëpërmjet përzgjedhjes së anëtarëve të rinj në këshillin e RTVM-së dhe kryesi të re
- Insistimi për pavarësi financiare dhe qëndrueshmëri të servisit publik
- Ngritjen e standardeve në RTVM nëpërmjet trajnimeve të përhershme të paktën 4 herë në vit për gazetarët, kameramanët dhe punonjësit tjerë mediatik, për të cilën është nënshkruar memorandum me redaktorët e 3 shërbimeve programore, TVM1, TVM2 dhe TVM 4 në nëntor të vitit 2022.

## **AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE (ASHMAA)**

- Insistimi për përzgjedhjen e anëtarëve të rinj të këshillit të ASHMAA në Kuvend,
- Mbikëqyrje e vazhdueshme e punës së Agjencisë posaçërisht për masat të cilat i shqipton kundër mediave.

## **KUFIZIMI I PUNËS SË PR-IT TË QEVERISË**

- Presion i vazhdueshëm mbi qeverinë për kufizimin e punës së shërbimeve për PR, kur bëhet fjalë për përzierjen e tyre në punën e

punonjësve mediatik. Duke e patur parasysh faktin se të gjithë ministrat qeveritar dhe drejtorë punësojnë gazetarë, kameramanë dhe fotoreporterë, Qeveria po imponohet si një nga mediat më të forta në vend, gjë që nuk duhet lejuar. Në këtë mënyrë po merret puna e profesionistëve mediatik dhe në vend të raportimeve të gazetarëve po servohet propaganda qeveritare.

- Kërkojmë që shërbimet qeveritare për PR të japin përgjigje dhe të dërgojnë komunikata, dhe jo të përgatiten materiale të gatshme me shkrime, video dhe foto. Në raste të jashtëzakonshme fotografitë dhe video materialet duhet të jenë qartë të shënuara me logo të Qeverisë.

## **RRITJA E TRANSPARENCËS SË INSTITUCIONEVE**

- Gazetarët në kohën e fundit janë duke u ankuar për transparencën e institucioneve në nivel qendror, ndërsa në nivel lokal gjendja është edhe më keq. Kërkojmë rritje të transparencës dhe përgjigje thelbësore të përgjigjeve të parashtruara nga gazetarët. Këtë çështje do ta komunikojmë në nivel të ministrave dhe drejtorëve të institucioneve.

## **MEDIUME LOKALE DHE RANONALE**

### **NDRYSHIMI I RREGULLOREVE TË ASHMAA-SË PËR MARRJEN E KONCESIONEVE - DETYRIMI PËR PUNËSIM TË KORRESPONDENTËVE NË 8 RAJONE**

- Në dhjetor do të kërkojmë nga ASHMAA ndryshimin e rregullores për marrjen e koncesioneve të televizioneve nacionale me insistimin që në kushtet të hyjë edhe punësimi i detyrueshëm i 8 korrespondentëve (minimum nga 2 njerëz, gazetarë dhe kameramanë) nga të gjitha rajonet në vend. Kjo do të mundësojë punësimin e 144 personave në tërë shtetin.
- Kërkesë për lehtësime shtesë për tarifën për koncesion dhe frekuencën deri te ASHMAA dhe AEK e cila do të vlejë për mediumet rajonale dhe lokale.

### **PUNËSIMI URGJENTE I TË GJITHË KORRESPONDENTËVE NË RTMV 1 DHE 2**

- Është dorëzuar kërkesë deri tek Ministria e Financave për takim me qëllim miratimin e punësimit të përhershëm të gazetarëve dhe

kameramanëve që tani më janë në RTVM 1 dhe 2, si dhe punësimin e të rinjve në qytetet ku ende nuk ka korrespondentë. Gjithsej bëhet fjalë për punësimin e 32 personave.

## **FUQIZIMIN E ROLIT TË QENDRAVE RAJONALE**

- Parashikohet përforcimi i rolit të 6 qendrave rajonale të SHGM-së nëpërmjet:
- Hapjen e zyrave të SHGM-së në bashkëpunim me RTVM dhe MIA, ose vet, në varësi nga nevojat e qendrave rajonale.
- Organizimin e trajnimeve, konferencave, rrjetëzimit të përbashkët të gazetarëve dhe kameramanëve, bashkëpunimi ndërkufitar.
- Takime të rregullta tematike të gazetarëve në kuadër të qendrave të tyre rajonale, me përkrahje të zyrës së SHGM-së.

## **ROLI I SHGM-SË**

Fuqizimin e seksioneve ekzistuese

- kameramanëve,
- gazetarëve sportiv,
- gazetarëve të rinj,
- fotoreporterëve,
- kritikuesve filmik

nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta dhe të posaçme, konferencave, seminareve, aktiviteteve për përforcimin e ekipit. Këto seksione i kemi krijuar ose rinovuar në katër vitet e kaluara me çka e kemi ngritur solidaritetin në profesionin në nivel të lartë. Puna duhet të vazhdojë me rol aktiv të anëtarëve të seksioneve dhe me përkrahje të zyrës së SHGM-së.

- Vendosjen e një sistemi të ri modern të kartelave për anëtarët dhe përmirësimin e kualitetit dhe mbrojtjes së kartelave të anëtarëve të SHGM-së
- Përfitime shtesë për anëtarësinë
- Në vitin 2023 organizimin e misionit ndërkombëtar me profesionistë nga organizata kredibile dhe të njohura për skanimin e gjendjes në sektorin mediatik me aksent të veçantë në rregullativën mediatike. Kjo donë të thotë se ekip i përfaqësuesve nga organizatat ndërkombëtare do të jenë në Shkup dhe do të kenë më tepër takime me gazetarë dhe me përfaqësues të institucioneve relevante, ndërsa pas zbatimit të

misioneve së bashku me SHGM-në do të publikojnë edhe raport me rekomandime.

- Përpunimin e planit strategjik 2023/2026 me përfshirjen e të gjithë anëtarëve në mënyrë transparente dhe ndihmë prej ekspertëve dhe personave profesional.

## **TRENING AKAMEDIA E SHGM-SË**

- Formimin e Akademisë së SHGM-së, sipas shembullit të shoqatës holandezë të gazetarëve me trajnime të vazhdueshme për raportimin e avancuar, për teknologjitë e reja, trajnime tematike në sektorë të ndryshme të gazetarisë, ekonomi, korrupsion, arsim, shëndetësi, punë sociale.
- Trajnimet do të mbahen brenda dhe jashtë Shkupit me pjesëmarrje aktive të gazetarëve të rinj, të gazetarëve të cilët mbulojnë fusha të ndryshme.
- Parashikohen të paktën 25 trajnime në nivel vjetor ose mbulim të 80 deri 100 ditë në vit në qendrat trajnuese në tërë shtetin.
- Pjesëmarrje e 300 deri 400 gazetarëve në vit.

## **VETRREGULLIMI DHE RREGULLIMI**

- Ndërtimin e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve dhe vizitës studimore të anëtarëve të rinj të Këshillit të Nderit pranë SHGM-së.
- Vazhdimin e bashkëpunimit dhe përkrahje për Këshillin për Etikë të Mediave në Maqedoni (KEMM) si partner strategjik i SHGM-së
- Ngritje e mëtutjeshme e rolit të mediave online në shoqëri nëpërmjet vetë-rregullimit,
- Mekanizma shtesë për Promedia.mk të jetë aktor relevant në tregun mediatik.

## **Çfarë kemi punuar në katër vitet e kaluara**

Rezultatet nga aktivitetet tona në katër vitet e kaluara mund të përkufizohen si të rëndësishme dhe me efekte konkrete të cilat qojnë deri tek realizimi i qëllimeve të SHGM-së. Së shkurti, këto janë disa nga aktivitetet në të cilat SHGM ka punuar në periudhën e kaluar.

- I kemi ndërtuar kapacitete e gazetarëve nëpërmjet bashkëpunimeve të përbashkëta dhe projekteve.
- Kemi riaktivizuar dhe formuar seksione të gazetarëve nga sektorë të ndryshëm - këtu janë seksioni i kameramanëve, seksioni për gazetarë të rinj, seksioni për gazetar sportiv dhe seksioni për fotoreporterë.
- Falë ndihmës juridike falas, vetëm në vitin 2022 kemi arritur të sigurojmë ndihmë juridike për 71 kolegë dhe kolege, ndërsa në katër vitet e fundit, rreth 250 gazetarë kanë kërkuar ndihmë juridike falas ose përfaqësim para gjykatës.
- Kemi siguruar vaksinim masiv kundër KOVID-19 për punëtorët mediatik.
- Aktivitete të vazhdueshme në formën e trajnimeve dhe seminareve.
- Trajnime dhe seminare për gazetarët në servis publik.
- Trajnime për gazetarët në kuadër të seksionit për gazetarë të rinj pranë SHGM-së.
- Avancimin e bashkëpunimit ndër-redaktues në formën e thirrjes publike për pjesëmarrje në storje hulumtuese.
- 96 reagime publike, çdoherë kur liria e mediave është vënë në pikëpyetje.
- Krijimi i Regjistrimit për medime profesionale Promedia.mk, në bashkëpunim me Këshillin për Etikë në Mediat.
- Riafirmimi i bashkëpunimit me MPB-në për siguri më të madhe të punonjësve mediatik për llogaridhënie dhe transparencë më të madhe.
- Ngritjen e vetëdijes për edukimin mediatik nëpërmjet punës në fushata dhe kyçjes në javën edukative mediatike.
- Miratimin e ndryshimeve në ligjin për përgjegjësi civile dhe shpifje, me të cilat dënimet për gazetarët ulen për pesë herë.
- Ndryshime në Kodin Penal ku sulmi mbi gazetarin do të trajtohet si sulm mbi personit zyrtar.

- Në bashkëpunim me PTHP-në, është emëruar prokuror i posaçëm i cili do të punojë në rastet në të cilat janë sulmuar ose janë nën kërcënim gazetarë.
- Përpjekjet sistematike të SHGM-së, që vetë-rregullimi të bëhet pjesë e shoqërisë maqedonase, ka rezultuar me ngritje të vetëdijes tek opinioni për shfrytëzimin e këtij mekanizmi.
- Përpjekje sistematike për rritjen e transparencës së gjyqësorit dhe organeve gjyqësore.

Nënkuptohet se mundet edhe më mirë. Sfidat lidhur me lirinë e mediave dhe rritjen shtesë të kualitetit dhe profesionalizmit të redaksive mbeten imperativi ynë edhe në periudhën e ardhshme.